



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM - ERZEN TIRANË

Nr. 854 / 17 prot

Tiranë më, 26 / 07 / 2018

VENDIM

Nr.6 Datë 07.02.2018

PËR

MIRATIMIN E RINOVIMIT TË LEJES PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR NËNTOKËSOR (PUSHPIM) NË AUTOSTRADËN TIRANË - DURRËS, KM 5 SUBJEKTI "HAKO" SHPK.

Në Zbatim të Ligjit Nr.111/2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore" Përkatësisht N.41 pika 1 gërma "e" N.50 pika 2; Vendimin Nr. 416, datë 13.5.2015 "Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore", Vendimit nr.5 datë 16.02.2016 Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor", Neni 7 pika 3, Vendimit Nr.6 datë 16.02.2016 Për miratimin e rregullores "Për funksionimin e Agjencisë së Basenit Ujor" Neni 11 pika 3. Këshilli i Basenit Ujor

V E N D O S I:

1. Miratimin e rinovimit të lejes për përdorimin e burimit ujor, për qëllime teknologjike dhe sanitare për subjektin "HAKO" shpk me administrator Z.Adnand Hako vendodhja autostrada Tiranë-Durrës km 5, njësia administrative Kashar, bashkia Tiranë .
2. Koordinatat e vendodhjes dhe parametrat hidrogeologjike :
 - a. Koordinatat e vendodhjes : X= 45 80 250 Y=43 96 200 Z=62.3 m
 - b. Prurja mesatare (kapaciteti i pusit) Q= 0.002 m³/s (2l/s)
 - c. Volumi i kërkuar Q_k=0.0013 m³/s (1.3l/s)
 - ç. Sasia e e ujit që jepet për përdorim Q= 0.0013 m³/s (1.3l/s)
 - d. Diametri Ø=311 mm
 - e. Thellësia e pusit h= 35 m
3. Ngarkohet ABU Ishëm Erzen për zbatimin dhe mbikqyrjen e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi mbas zbardhjes dhe njoftimit të palës së interesuar .

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR ISHËM-ERZEN

SEKRETARI

Shpëtim MEDIU

KRYETAR

Suzana JAHOLLARI

